

Vendim nr. 18, datë 21.01.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Genti Ibrahim, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 21.01.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 23 (D) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DAVID QOSAJ**, përfaqësuar nga avokat Marash Logu, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 118, datë 13.12.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 5, datë 30.01.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2024-1953, datë 21.11.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 30, 31, 42, 131, 134, 135 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 02.09.2016, rreth orës 11:50, shërbimet e policisë pranë sallës operative të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë kanë marrë njoftim nga një banor i fshatit Torovicë se një fqinj i tij, shtetasi David Qosaj (kërkuesi), ka dalë nga banesa e tij dhe ka qëlluar me automatik, duke shtuar edhe se ai kishte probleme mendore dhe ishte me natyrë agresive. Forcat e policisë kanë ndërhyrë për kapjen e kërkuesit. Gjatë pozicionimit të tyre, nga banesa e kërkuesit është qëlluar me armë dhe, si pasojë, është plagosur punonjësi i policisë A.K. Ky i fundit, më pas, për shkak të dëmtimeve të pësuar, ka humbur jetën. Në vijim, kërkuesi ka arritur të largohet nga banesa, duke tentuar të fshihet në një parcelë me misër, por është kapur nga shërbimet e policisë, duke iu sekuestruar edhe arma që mbante.

2. Për këtë ngjarje, mbi bazën e materialit kallëzues të dërguar nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. 180/2016 për veprat penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, me pasojë vdekjen e një shtetasi, “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, e mbetur në tentativë, në dëm të dy shtetasve, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, të parashikuara nga nenet 79/b, 79/b e 22, 278, paragrafi i katërt, dhe 280 të Kodit Penal (KP). Në kuadër të këtij procedimi penal, mbi kërkesën e prokurorit, me vendimin e datës 06.09.2016, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kërkuesit, duke caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në burg”. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga gjykatat më të larta.

3. Gjatë hetimit paraprak, me vendim të organit procedues, është urdhëruar kryerja e ekspertimit psikiatriko-ligjor të kërkuesit. Sipas aktit të ekspertimit nr. 405, datë 21.11.2016 të Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML), është konkluduar se kërkuesi: (i) nuk vuan nga probleme të shëndetit mendor; (ii) plotëson kriteret diagnostike për tipare të çrregullimit të personalitetit skizoid; (iii) megjithëse çrregullimet e personalitetit janë model me të cilin funksionon individi dhe, nga pikëpamja psikiatriko-ligjore, kanë elemente të cilat ndikojnë në uljen e përgjegjshmërisë, si dekompensimi i tyre në kohën e kryerjes së veprës, një gjë e tillë nuk ka ndodhur në rastin konkret; (iv) asnjë nga çrregullimet që prezanton ai nuk është i tillë që ta bëjë të papërgjegjshëm në kryerjen e veprës penale dhe ai është i aftë të kuptojë veprimet që kryen e të llogarisë pasojat e tyre.

4. Në vijim, me vendimin e datës 30.11.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka pushuar hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 280 i KP-së, për shkak se arma e gjahut e gjetur në banesën e kërkuesit gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes, është në gjendje jo të rregullt teknike dhe nuk mund të realizojë qitje. Nga ana tjetër, me vendim të së njëjtës datë, kërkuesi është marrë i pandehur, duke u akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/b, 79/b dhe 22, si dhe 278, paragrafi i katërt, të KP-së. Në përfundim të hetimeve paraprahe, në datën 20.12.2016, çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

5. Gjatë gjykimit të çështjes, me kërkesë të mbrojtjes, gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor të të pandehurit (kërkuesit), duke ia nënshtruar debatit gjyqësor. Në këtë kuadër, ajo ka pyetur edhe ekspertët që kishin përpiluar aktin. Më pas, ajo gjykatë ka urdhëruar kryerjen e një ekspertimi të ri psikiatriko-ligjor, duke caktuar tre ekspertë të tjerë. Në aktin e ri të ekspertimit, këta ekspertë kanë arritur në konkluzionet se: (i) referuar ekzaminimit objektiv të të pandehurit dhe kartelës klinike mjekësore pranë Institucionit të Veçantë të të Burgosurve, gjendja e shëndetit mendor të tij ishte e stabilizuar; (ii) në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka vuajtur nga çrregullim i personalitetit skizotipal dhe se ky çrregullim ka ndikuar në kryerjen e veprës penale, duke ulur ekuilibrin e tij, por pa e përjashtuar atë nga përgjegjshmëria përpara ligjit për veprën penale të kryer. Edhe ky akt ekspertimi i është nënshtruar debatit gjyqësor.

6. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 118, datë 13.12.2017, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, me pasojë vdekjen e punonjësit të policisë A.K., të parashikuar nga neni 79/b i KP-së, dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm, “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, e mbetur në tentativë, në dëm të punonjësve të policisë E.B. dhe V.T., të parashikuar nga nenet 79/b, 22 e 23 të KP-së, dhe dënimin e tij me 30 vjet burgim, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i tretë, i KP-së, dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, kërkuesi është dënuar me një dënim të vetëm, me burgim të përjetshëm. Gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se, bazuar në aktet dhe provat e shqyrtuara, nga vlerësimi i tyre veç e veç dhe në tërësi, konform kërkesave të nenit 152, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), fajësia e kërkuesit për veprat penale për të cilat akuzohej provohej përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Gjykata është ndalur, në veçanti, në aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor të marrë gjatë gjykimit, duke arsyetuar se përse nuk i ka marrë parasysh ato përfundime të ekspertëve që kishin ndikim në caktimin e masës së dënimit ndaj kërkuesit, duke vlerësuar se ato nuk ishin bindëse dhe nuk lidheshin me prova të tjera. Sipas asaj gjykate, referuar të dyja akteve të ekspertimit psikiatriko-ligjor, nuk janë kushtet kur aftësia për të gjykuar e të pandehurit (kërkuesit) të ketë qenë e ndikuar nga sëmundja mendore, që do të thotë se gjendja mendore e tij nuk ka qenë e ndryshme nga ajo e çdo personi tjetër që do të konsiderohej normal. Sipas saj, kërkuesi nuk konsiderohet si i sëmurë psikik ose njeri me përgjegjësi të kufizuar dhe se vepra nuk është kryer në gjendje të afektit të alteruar (turbullimit të fuqishëm psikik). Kundër vendimit ka paraqitur ankim kërkuesi, duke kërkuar prishjen e tij dhe pushimin e çështjes, ose cilësimin e saktë të veprës penale, ose kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë.

7. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, fillimisht, me vendimin nr. 47, datë 03.04.2018, ka vendosur konstatimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda, duke prishur vendimin nr. 118, datë 13.12.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe duke e dërguar çështjen në gjykatën kompetente, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Mbi ankimin e prokurorit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2018-316, datë 12.09.2018, ka vendosur dërgimin e akteve në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda për vazhdimin e gjykimit, si gjykata që ka kompetencë lëndore për gjykimin e çështjes.

8. Gjatë vazhdimin të gjykimit në apel të çështjes në themel, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, nisur edhe nga kërkimet e mbrojtjes, ka përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor, me qëllim verifikimin e gjendjes aktuale të shëndetit fizik e mendor të kërkuesit, bazuar në mjekimin dhe shërbimin shëndetësor që i ofrohej atij në kushtet e paraburgimit pranë institutit përkatës të ekzekutimit të vendimeve penale. Në këtë kuadër, gjykata e apelit ka pranuar kërkesën e mbrojtjes për pyetjen e mjekes psikiatre të Institutit të Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (IVSHB), si dhe për administrimin në gjykim të kartelës klinike të kërkuesit nga koha e diagnostikimit të tij dhe deri më 07.11.2018. Po kështu, gjykata e apelit ka pranuar edhe kërkesën e mbrojtjes për pyetjen si dëshmitarë të dy mjekëve të IVSHB-së. Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka refuzuar kërkesën e mbrojtjes për kryerjen e një akti të ri ekspertimi psikiatriko-ligjor, duke konsideruar të ezauruar marrjen e kësaj prove, si në hetimin paraprak, ashtu edhe në gjykimin në shkallë të parë, akte të cilat do të vlerësoheshin në harmoni edhe me provat e tjera të marra në gjykimin në apel.

9. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 5, datë 30.01.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 118, datë 13.12.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Sipas gjykatës së apelit, vlerësimi i saj juridik dhe i fakteve është i njëjtë me konkluzionin e arritur nga gjykata e shkallës së parë, pasi nga provat dhe aktet e shqyrtuara gjatë atij gjykimi është provuar, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se kërkuesi ka konsumuar veprat penale për të cilat është akuzuar, duke i gjetur të pabazuara shkaqet e ankimit në këtë drejtim. Po sipas asaj gjykate, vendimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë edhe në lidhje me masën e dënimit të caktuar, si për secilën veprë penale për të cilën kërkuesi është gjetur fajtor, ashtu edhe për sa i përket bashkimit të dënimeve në zbatim të nenit 55 të KP-së. Kundër vendimit ka paraqitur rekurs kërkuesi, përmes mbrojtësit të tij.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1953, datë 21.11.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së. Sipas atij kolegji, pretendimet e kërkuesit për vlerësimin e gabuar të fakteve dhe të provave, cilësimin juridik të veprës penale, gjendjen mendore dhe ato për individualizimin e dënimit janë parashtruar edhe në ankim e janë marrë në shqyrtim gjerësisht nga gjykata e apelit. Për pretendimin se kërkuesi ka qenë i papërgjegjshëm në momentin e kryerjes së veprës penale, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjatë hetimit dhe gjykimit, nga aktet e ekspertimit psikiatriko-ligjor nuk është vënë në diskutim përgjegjshmëria e kërkuesit në momentin e kryerjes së veprës penale, por ndërmjet atyre dy akteve ka vlerësime të ndryshme në lidhje me uljen e ekuilibrit në momentin e kryerjes së veprës penale, rrethanë që mbahet në konsideratë në caktimin e dënimit. Ndërkohë, sipas atij kolegji, gjykatat e faktit kanë marrë për bazë aktin e ekspertimit të datës 21.11.2016, që ka konkluduar se nuk ka pasur ulje ekuilibri në momentin e kryerjes së veprës penale, duke parashtruar edhe arsyet për këtë qëndrim. Edhe për sa u përket pretendimeve për masën e dënimit të caktuar, Kolegji Penal ka vlerësuar se ato janë marrë në shqyrtim gjerësisht nga gjykata e apelit, vendimi i së cilës është i mirëarsyetuar, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankim. Në vlerësimin e atij kolegji, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk ka mosrespektim ose zbatim të gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe vendimi i ankimuar nuk vjen në kundërshtim me praktikën e tij ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

11. Në datën 17.11.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Ky ankim, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 27.11.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

12.1. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat e kanë filluar procesin me bindjen se ai i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej dhe, të ndikuara edhe nga rëndesa e ngjarjes (humbja e jetës së një punonjësi policie në krye të detyrës), ato nuk morën dhe as nuk kanë pranuar të marrin provat e kërkuara nga mbrojtja që shkonin në favor të pafajësisë së tij. Gjykatat duhet t`u jepnin përgjigje pyetjes nëse provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi:

12.1.1. Është autor i vrasjes së punonjësit të policisë. Lidhur me këtë, nga këqyrjet, aktet e ekspertimit balistik dhe dëshmitë, ka ekzistuar dyshimi se, për shkak të shkëmbimit të shpeshtë të zjarrit dhe pozicionimit të punonjësve të policisë përpara dhe mbrapa shtëpisë, mund të ketë pasur kryqëzim zjarri që ka çuar në vrasjen aksidentale të viktimës. Akti i ekspertimit mjeko-ligjor tregon se plaga në trupin e viktimës ishte nga mbrapa me drejtim nga lart-poshtë, çka nuk përkonte me pozicionin e kërkuesit, i cili ndodhej më poshtë pemës pas së cilës ishte fshehur viktimja. Nëse do të ishte ai autori, plaga te viktimja do të ishte nga përpara me drejtim nga poshtë-lart. Ky dyshim duhet të shkonte në favor të kërkuesit. Për të sqaruar përfundimisht këtë dyshim të ngritur nga mbrojtja, organi i akuzës gjatë hetimit ose gjykata gjatë gjykimit duhet të urdhëronin kryerjen e një eksperimenti hetimor, sipas neneve 176 e 177 të KPP-së. Mosmarrja e kësaj prove ka cenuar edhe *parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën për mbrojtje efektive*.

12.1.2. E ka kryer me dashje vrasjen e punonjësit të policisë. Lidhur me këtë, nga aktet e ekspertimit, këqyrjet dhe dëshmitë e marra, për shkak të relievit dhe bimësisë (pemë, barishte, shkurre të larta) rreth banesës së kërkuesit, fushëpamja e tij ka

qenë e pamundur. Pavarësisht kësaj, është pranuar se kërkuesi ka pasur fushëpamje të plotë të portës, rrugicës që lidh portën hyrëse me rrugën kryesore dhe të vet rrugës kryesore, çka është logjikisht e papranueshme. Një eksperiment hetimor do të tregonte se as kërkuesi, as punonjësit e policisë nuk mund të shihnin qartë veprimet, lëvizjet dhe pozicionimin e njëri-tjetrit, element ky shumë i rëndësishëm, si për përcaktimin e fajësisë, ashtu edhe për cilësimin juridik të veprës penale, pra nëse ajo është kryer me dashje apo nga pakujdesia.

12.1.3. Ka qenë i përgjegjshëm përpara ligjit në momentin e ngjarjes. Lidhur me këtë, nga aktet e ekspertimit, dëshmitë dhe provat shkresore të administruara, ka rezultuar se kërkuesi vuante prej vitesh nga probleme të shëndetit mendor, i përkeqësuar veçanërisht pas humbjes tragjike të një vëllai të tij, fakt ky i njohur nga familja, banorët dhe mjeku i fshatit. Kërkesa e mbrojtjes për thirrjen si dëshmitarë të banorëve të fshatit është refuzuar. Edhe personi që ka njoftuar policinë ka informuar se kërkuesi vuante nga probleme të shëndetit mendor, të cilat u evidentuan edhe nga aktet e ekspertimit, duke pasur edhe diferenca në këto akte. Në kushtet kur gjatë procesit gjyqësor janë administruar dy akte ekspertimi psikiatriko-ligjor me diferenca të qarta në konkluzionet e tyre, gjykatat, bazuar në nenet 179 e vijues të KPP-së, duhet të kishin urdhëruar ekspertim me grup të ri ekspertësh, për t'i dhënë përgjigje përfundimtare çështjes së (pa)përgjegjshmërisë së kërkuesit në kohën e kryerjes së veprave penale.

12.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjykata e apelit, fillimisht, bazuar në ndryshimet përkatëse të KPP-së, ka vlerësuar se gjykimi i çështjes ishte në kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, por Gjykata e Lartë e prishi vendimin, duke ia kthyer aktet asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit. Megjithëse është kërkuar njohja me atë vendim, ai nuk është vënë ende në dispozicion nga Gjykata e Lartë. Megjithatë, vendimi fillestar i gjykatës së apelit është i drejtë, pasi veprat penale për të cilat akuzohej kërkuesi nuk përfshihen në ato të parashikuara në nenin 75/a të KPP-së, për pasojë, gjykimi duhej të bëhej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore.

- 12.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës për mbrojtje efektive*, për shkak të moskryerjes së eksperimentit, refuzimit të kryerjes së riekspertimit psikiatriko-ligjor dhe mosthirrjes së dëshmitarëve, çka e ka vendosur kërkuesin në një pozicion të pafavorshëm në raport me organin e akuzës, duke i dhënë avantazh këtij të fundit. Moskryerja e eksperimentit lidhur me faktin nëse kërkuesi e ka kryer apo jo efektivisht veprën penale dhe nëse ajo është kryer me dashje apo nga pakujdesia, moskryerja e riekspertimit me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë penale të kërkuesit, si dhe mosthirrja e dëshmitarëve që mund të dëshmonin për historikun e gjendjes mendore të tij, e kanë vënë mbrojtjen e kërkuesit në pamundësi objektive për të provuar pretendimet për pafajësinë e tij.
- 12.4. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, nuk i ka dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes, duke i mohuar kërkuesit të drejtën për të marrë përgjigje të arsyetuar për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs. Pavarësisht se ka vendosur mospranimin e rekursit, Kolegji Penal është ndalur në disa prej pretendimeve të kërkuesit, por nuk jep një përgjigje të arsyetuar, duke u mjaftuar me konstatime të përgjithshme, të cilat janë përsëritje e konstatimeve të gjykatës së apelit, pavarësisht funksionit që ka Gjykata e Lartë.
- 12.5. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi kërkesa për gjykimin e çështjes penale është paraqitur në gjykatën e shkallës së parë në datën 20.12.2016 dhe ajo gjykatë ka disponuar me vendim në datën 13.12.2017, pas rreth 1 viti. Në gjykatën e apelit çështja është regjistruar në datën 05.01.2018 dhe ajo ka disponuar me vendim në datën 30.01.2019, pas rreth 1 viti. Nga viti 2019, kur është paraqitur rekursi, deri në marrjen e vendimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë më 21.11.2024, kanë kaluar 5 vjet, çka, duke pasur parasysh kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese, përbën cenim të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ndërkohë që as sjellja e kërkuesit, as kompleksiteti i çështjes, duke pasur parasysh vendimmarrjen për mospranim rekursi, nuk e justifikojnë një kohëzgjatje të tillë të procesit gjyqësor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuësi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuësin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare. Edhe pse kriteret e legjitimitimit kanë të njëjtën peshë në këtë fazë të shqyrtimit paraprak, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, kjo nuk nënkupton se në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i më shumë se një kriteri, ato humbasin rëndësinë dhe karakterin kumulativ të tyre.

15. Kolegji, referuar përmbajtjes së akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, vëren se pretendimi për kryerjen e eksperimentit, i ngritur në drejtim të parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës për mbrojtje efektive, si dhe ai për të drejtën për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, nuk janë ngritur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, për këto pretendime nuk plotësohet kriteri i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që nënkupton, në aspektin formal, që kërkuësi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t’i drejtohet Gjykatës, si dhe, në aspektin substancial, që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në të gjitha shkallët e gjyimit, të paktën në

substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, përfshirë edhe kriterin e mjetit juridik efektiv, pra që pretendimi të jetë ngritur përpara asaj gjykate që realisht ka kompetencën dhe mundësinë ta riparojë shkeljen e pretenduar (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i parashikimit të këtij kriteri në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime t’i paraqiten Gjykatës (*shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 5, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Po në këtë drejtim, Kolegji vlerëson të theksojë edhe se pretendimi i kërkuarit se nuk i është vënë në dispozicion vendimi i Gjykatës së Lartë që ka zgjidhur çështjen e kompetencës është i papranueshëm, për sa kohë që ai ka pasur mundësi reale procedurale ta ngrejë këtë pretendim gjatë vazhdimit të gjykimit të çështjes së tij në apel dhe/ose në rekurs, duke kërkuar vënien në dispozicion të atij vendimi, si element i ushtrimit efektiv të mjeteve të ankimit dhe i së drejtës së aksesit në vendimmarrjen gjyqësore. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, duke iu referuar, në thelb, kohëzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, i cili është regjistruar më 12.03.2019 dhe është shqyrtuar në dhomën e këshillimit më 21.11.2024, pra pas më shumë se 5 vjetësh. Sipas kërkuarit, as sjellja e tij, as kompleksiteti i çështjes, duke pasur parasysh vendimmarrjen e asaj gjykate për mospranimin e rekursit, nuk justifikojnë një kohëzgjatje të tillë të procesit gjyqësor. Kolegji vëren se në kohën që çështja e kërkuarit ka qenë në gjykim në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë edhe kur ajo është regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe ka qenë në pritje të shqyrtimit, kishin hyrë në fuqi mjetet e reja juridike për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit, sipas neneve 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile. Këto mjete mbrojnë të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm edhe në rastin e procedimeve penale, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit. Për sa u përket efektivitetit të tyre, Gjykata ka vlerësuar se, në parim, legjislacioni parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra, ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimet nr. 11, datë 28.02.2024; nr. 37, datë 15.11.2021; nr. 80, datë 18.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

Pavarësisht kësaj, kërkuesi, edhe pse i ka pasur të gjitha mundësitë që të përdorte këto mjete efektive në dispozicion, jo vetëm që nuk rezulton t'i ketë përdorur ato, por as nuk ka parashtruar ndonjë shkak për pamundësinë e përdorimit ose mungesën e efektivitetit të tyre në rastin konkret. Për rrjedhojë, edhe për këtë pretendim, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive.

18. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues individual, për të cilat kërkuesi ka shteruar mjetet e ankimit, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me provueshmërinë e kryerjes së veprës penale prej tij në nivelin tej çdo dyshimi të arsyeshëm, cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës për mbrojtje efektive në drejtim të shqyrtimit të kërkesave të mbrojtjes për marrjen e provave nga gjykata, konkretisht ato me dëshmitarë e ato shkencore dhe kryerjen e një akti të ri ekspertimi psikiatriko-ligjor, si dhe cenimin e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit, për shkak se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

19. Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në kuptim të këtyre standardeve, Kolegji, bazuar në natyrën dhe përmbajtjen e argumenteve të parashtruara nga kërkuesi në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, vlerëson se ato kanë të bëjnë, në thelb, me mënyrën e vlerësimit të provave mbi të cilat gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundim se ai është fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe, si të tilla, duke pasur natyrë thellësisht ligjore, nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues përveçse kur ky vlerësim shfaq arbitraritet të dukshëm,

mungesë arsyetimi, ose cenon në thelb standardin e gjykimit të drejtë. Kolegji vëren se gjykatat e faktit, pasi kanë marrë në shqyrtim provat e administruara, të cilat ia kanë nënshtruar debatit gjyqësor, kanë arsyetuar në vendimet e tyre lidhur me mënyrën e vlerësimit të këtyre provave dhe, veçanërisht, të përfundimeve të akteve të ekspertimit dhe të riekspertimit psikiatriko-ligjor, në funksion të përfundimit të arritur për fajësinë e kërkuesit. Këto vendime nuk rezultojnë të jenë haptazi arbitrare, alogjike ose të paarsyetuara, në atë masë që të vënë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për një gjykim të drejtë. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

21. Për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës për mbrojtje efektive, Gjykata ka theksuar se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë, po ashtu, në kompetencë të saj (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 9, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket të drejtës së mbrojtjes në procesin penal, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Bazuar në këto parime, Kolegji, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, konstaton se gjykatat e zakonshme kanë dëgjuar si dëshmitarë edhe disa persona të thirrur nga mbrojtja, konkretisht vëllain e kërkuesit dhe dy shtetas të tjerë, të cilët nuk kanë deklaruar të dhëna për ngjarjen, por për situatën shëndetësore, familjare e personale të kërkuesit. Po kështu, gjykatat kanë shqyrtuar e debatuar në gjykim përfundimet e aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor, duke lejuar edhe riekspertimin, kanë pyetur ekspertët që i kanë përpiluar ato, kanë administruar kartelën klinike të kërkuesit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, si dhe kanë pyetur edhe disa mjekë të IVSHB-së. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se nuk rezultojnë që kërkuesi të jetë vënë në pozita jo të barabarta me palën tjetër, prokurorinë, pasi përgjatë procesit gjyqësor atij i është dhënë

mundësia, në funksion të mbrojtjes së tij që, përmes mbrojtësit ligjor, të paraqesë dhe të kërkojë marrjen e provave, si dhe të paraqesë përpara gjykatave pretendimet dhe kundërshtitë e tij në lidhje me përfundimet e akteve të ekspertimit dhe konkluzionet e ekspertëve. Vetëm fakti që gjykata e apelit nuk ka pranuar kërkesën për kryerjen e një ekspertimi të tretë, nuk është i tillë që të vërë në dyshim procesin gjyqësor në atë gjykatë, për sa kohë ajo ka parashtruar argumentet mbi bazën e të cilave ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

23. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se Kolegji Penal ka vendosur mospranimin e rekursit, edhe pse në të ishin ngritur pretendime kushtetuese, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin e saj si gjykatë e ligjit, si dhe në zbatim të normave procedurale që gjejnë zbatim në atë shkallë gjykimi, pasi ka marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit rekursin e kërkuarit, ka vlerësuar se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e nenit 432 të KPP-së. Sipas asaj gjykate, të gjitha pretendimet e ngritura përpara saj kanë marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykata e apelit, konkretisht ato për mënyrën e vlerësimit të provave, për papërgjegjshmërinë e kërkuarit në referim të përmbajtjes dhe të konkluzioneve të akteve të ekspertimit psikiatriko-ligjor, si dhe për cilësimin e veprës penale, duke i gjetur të pabazuara.

24. Gjykata ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i këtyre lloj vendimesh nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor, pasi kjo formë arsyetimi shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimin të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe është tregues i faktit që kërkuari nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjisllacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka listuar në pjesën hyrëse të vendimit pretendimet me natyrë kushtetuese të kërkuarit, duke u dhënë atyre përgjigje me arsyetim të kufizuar, të mjaftueshëm, nga pikëpamja kushtetuese, për vendimmarrjet e mospranimin në dhomën e këshillimit, për aq sa ky nivel arsyetimi përmbush standardin minimal të qartësisë dhe lejon edhe kontrollin e vendimmarrjes së asaj gjykate. Vetëm fakti se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit nuk është argument i mjaftueshëm në nivel

kushtetues për të vënë në dyshim procesin e zhvilluar në atë gjykatë. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim i kërkuessit është haptazi i pabazuar.

26. Në këndvështrim të sa më lart, duke qenë se kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë kumulative, Kolegji çmon të mos ndalet në analizën e mëtejshme të plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitit të kërkuessit.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuessit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.